

SHKATËRRIMI I MENDIMIT ISLAM PAS INSTALIMIT TË REGJIMIT KOMUNIST NË VITET 1945 -1967

*THE DESTRUCTION OF ISLAMIC THOUGHT AFTER THE
INSTALLATION OF THE COMMUNIST REGIME IN THE YEARS
1945 -1967*

Roald A. HYSA

Independent Researcher, Albania

 <https://orcid.org/0009-0007-6350-5216>

Abstrakt: Me këtë kumtesë të shkurtër synoj të jap se si u dëmtua në mënyrë të pariparueshme mendimi islam në gjuhën shqipe, i cili daton me botimet më të hershme në fillim të shek. XX e në vijim. Botime të shumta dhe dy revistat e Komunitetit Mysliman gjeneruar përmes artikujshkruesve të shumtë mendimin zyrtar islam në territorin e Shqipërisë. Mirëpo instalimi i regjimit komunist në Shqipëri e ndërpreu vijimësinë e natyrshme të këtij mendimi për ta shkatërruar sistematikisht edhe atë trashëgimi të mbetur në librat dhe revistat islame, duke i ndaluar ato nga qarkullimi dhe duke i mbledhur për t'i djegur.

Fjalët kyçe: mendimi islam, kultura islame, trashëgimi, censura

Abstract: With this short paper, I aim to show how Islamic thought in the Albanian language was irreparably damaged, a tradition that dates back to the earliest publications at the beginning of the 20th century and onward. Numerous publications and the two journals of the Muslim Community, through the writings of many contributors, generated the official Islamic thought within the territory of Albania. However, the establishment of the communist regime in Albania interrupted the natural continuity of this thought, systematically destroying even the remaining legacy found in Islamic books and journals by banning their circulation and collecting them to be burned.

Keywords: Islamic thought, Islamic culture, legacy, censorship



Corresponding author: Roald A. Hysa, agonk122@gmail.com



Citation: Hysa, Roald A. "Shkatërrimi i mendimit islam pas instalimit të regjimit komunist në vitet 1945–1967." In *Balkan Periodicals: The Trajectory of Islamic Thought in the Communist Period*, edited by Sevba Abdula, Ahmet Koroğlu, and Fatih Şabani, 28–42. Skopje: IDEFE Publications, 2025. <https://doi.org/10.51331/EB11RH>.

Hyrje

Me këtë kumtesë synoj të jap se si u dëmtua në mënyrë të pariparueshme mendimi islam në gjuhën shqipe, i cili daton me botimet më të hershme në fillim të shek. XX e në vijim. Botime të shumta dhe dy revistat (Zani i Naltë dhe Kultura Islame) e Komunitetit Mysliman kanë gjeneruar përmes artikujshkruesve të shumtë mendimin zyrtar islam në territorin e Shqipërisë. Mirëpo instalimi i regjimit komunist në Shqipëri e ndërpreu vijimësinë e natyrshme të këtij mendimi për ta shkatërruar sistematikisht edhe atë trashëgimi të mbetur në librat dhe revistat islame, duke i ndaluar ato nga qarkullimi dhe duke i mbledhur për t'i djegur.

Pas vitit 1945 të gjitha botimet e KMSH-së ndërpritën në mënyrë kategorike nëpërmjet justifikimeve të ndryshme nga pushteti komunist. Për një farë kohe vazhdoi botimi i revistës Kultura Islame dhe vërehet se drejtori i saj Sadik Bega, mundohej të kapte ritmin mujor të botimit të kësaj reviste. Tre numra arritën të dilnin me sforcim nga ana e redaksisë dhe për fat në këto tre numra na paraqiten ndryshimet rrënjësore që pësoi në drejtim Komuniteti Mysliman i Shqipërisë.

Stafi i ri drejtues me kryetar H. Musa Aliun pati një preokupacion të posaçëm edhe për botimet e KMSH-së, madje në planet e tij vërehen edhe karakteristikat e botimeve që duhen të kenë librat e këtij komuniteti, të cilat kanë të bëjnë me llojin e germave dhe jo vetëm krizën e gjithanshme sociale e ekonomike, që po përjetonte Shqipëria asokohe. Në planet e Stafit të ri drejtues të KMSH-së hynte edhe blerja e një shtypshkronje me germa arabe e shqipe për botime librash, por kjo pasi të rregullohej gjendja e arkës së Komunitetit¹. Gjendja e arkës së KMSH-së, me gjithë premtimet për subvencionimet qeveritare, nuk arriti të rregullohej asnjëherë në vitet në vijim, kështu që e pësuan edhe botimet fetare.

Për t'i vënë fre ndikimit fetar, shteti komunist në fillim vuri censurë mbi shtypin fetar pastaj e ndaloi atë me pretendimin se “nuk ka letër”. Edhe për të botuar kalendarin e faljeve duhej të merrej leje nga qeveria². Ja se si e shpjegon situatën e krijuar në ato çaste Enver Hoxha: “Kurse për sa i përket botimit të librave e të dogmave të tyre, kjo mundësi ka vdekur me kohë për ta. Myslimanët as kanë, as mund të kenë dhe as mund të lexojnë ndonjë Kuran të vjetër, pse ai është në arabisht. Praktikisht ata “rrojnë» me disa syre të Kuranit, që i mësojnë përmendsh, që nuk i kuptojnë dhe i transmetojnë gojarisht³.”

1 Komuniteti Mysliman në periudhën e lirisë, *Kultura Islame*, nr. 3-4 (1945): 61.

2 Ali M. Basha, *Rrugëtimi i Fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)*, (Tiranë: Botimi Privat, 2011), 435.

3 Enver Hoxha, “Praktikat fetare t'i luftojmë me frymën patriotike dhe revolucionare të masave,” *Vepra*, (1967); *Vepra*, nr. 35 (1982): 104-105.

Megjithë përpjekjet e stafit të KMSH-së për përkthimin dhe botimin në shqip të Kuranit, kjo nuk u bë e mundur, se regjimi komunist nuk mund ta lejonte një gjë të tillë pavarësisht justifikimeve që dhanë në takime private. Hafiz Musa Ali Basha i kishte kërkuar në një takim Enver Hoxhës ndër të tjera edhe letër për botimin e Kuranit për të cilin po punohej prej kohësh⁴. Komisioni i përkthimit të Kuranit në vitin 1946 ka qenë i përbërë nga Hafiz Ismet Dibra, kryetar, Sadik Bega, Haki Sharofi e Jonuz Bulej anëtarë dhe Hasan Tahsini sekretar, Jonuz Bulej ka paraqitur dorëheqjen nga ky komision në vitin 1949⁵. Enver Hoxha e ka inkurajuar kryemyftiun (hafiz Musa Aliun) të vazhdojë me përkthimin e Kuranit, por letër për botimin e Kuranit nuk i dha duke u justifikuar, se gjendja me letrën në vend është shumë e rëndë dhe se qeveria nuk mund ta ndihmojë Komunitetin Mysliman për këtë çështje...⁶, ndërkohë që literatura e propagandës ateiste-komuniste botohej e shtypej rregullisht.

Revista *Kultura Islame* ka një shkëputje nga numri i tetorit 1944 dhe vijon të dalë me numrat 3-4 të prill 1945. Ky numër hapet me editorialin e titulluar “Lirija nuk dhurohet, por merret”. Në këtë shkrim bëhet një përmbledhje historike e Lëvizjes Nacional-Çlirimtare dhe e të gjithë datave të saj që do të shenjojnë më pas edhe historinë tejet të politizuar nga regjimi monist, si Konferenca e Pezës, Kongresi i Përmetit, Kongresi i Beratit, si dhe pasojat e tyre për historinë e Shqipërisë. Nga e gjithë kjo që ka cituar ky shkruer shihet qartazi sipas tij, se bien poshtë “pretencat e pathemelta të okupatorit e të klikave reaksionare, të cilat kanë dashë me e paraqitë luftën N.Ç. si një luftë e cila kërkonte të prishi institucionet e kaluara, zakonet dhe traditat e mira, e për sa i përket rastit tonë, të përmbysi komunitetet fetare. Këto pretenca kanë qenë të pathemelta, sepse na shohim se në gjirin e saj morën pjesë dhe marrin ende fetarët, si hoxhallarë, baballarë bektashi, shehlerë...”⁷ Pretendimi i artikullshkruesit nuk është krejtësisht i pathemeltë, sepse me të vërtetë ka pasur në krahun e L.N.Ç. klerikë muslimanë, të cilët të tërhequr nga propaganda kaluan me Frontin dhe e përkrahën dhe luftuan me idealet e lirisë dhe të largimit të pushtuesve nga vendi. Zgjerimi i veprimtarive fetare, thuhet në një qarkore të qeverisë në vitin 1951, bie ndesh me politikën e partisë dhe të pushtetit, sepse rrit influencën e dogmës fetare në popull dhe zbeh autoritetin e partisë⁸.

4 Ali M. Basha, *Rrugëtimi i Fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)*, (Tiranë: Botimi Privat, 2011), 457.

5 Po aty, 457.

6 Po aty, 457-458.

7 *Kultura Islame*, nr. 3-4 (1945): 58.

8 Ajet Shahu, “Marrëdhëniet e shtetit komunist me fenë islame në Shqipëri (1945-1967),” *Feja, Kultura dhe Tradita Islame ndër Shqiptarët* (Prishtinë: BIK, 1995), 512.

Ndërkaq edhe ajo literaturë fetare e shtypur para vitit 1944 u pa si e rrezikshme nga regjimi, i cili shumë shpejt u mor me konfiskimin e kësaj literature dhe shkatërrimin e saj sistematik. Dekretligji mbi Komunitetet fetare i 26 nëntorit 1949 i fuste nën një kontroll të rreptë komunitetet nga ana shtetërore. Studiuesi Sh. Hysi vëren, se: “Ky ligj i linte vetëm të drejtën e predikimit dhe të ritualeve të domosdoshme fetare, duke ua hequr të drejtën e veprimtarive të tjera, bamirëse e propagandistike në publik, si libra, postera etj.”⁹ Nën këtë prizëm duhet të shihen të gjithë veprimet e mëvonshme mbi sekuestrimet e bibliotekave dhe të librave fetare që u bënë nga organet e ndryshme, duke vendosur kështu një censurë të ashpër edhe për botimet e përpara vitit 1944.

Më 26/12/1950 librashitësi Liman Osman Selishta e njofton Komunitetin Mysliman se inspektorët e seksionit të kulturës i kanë kontrolluar librarinë dhe i kanë marrë 11,300 copë libra. Titujt e bllokuar janë rreth 15, ku mbizotëron literatura bazë dhe dy revistat e KMSH-së Zani i Naltë dhe Kultura Islame. KMSH-ja si përgjigje nga Komiteti Ekzekutiv i Tiranës ka marrë, se: “Mbas bllokimit do të formohet një komision që do të merret me shqyrtimin dhe do të lerë në shitje të lirë ata libra që nuk kanë përmbajtje fashiste apo reaksionare. Në fakt librat nuk u zhblokuan asnjëherë dhe pronari nuk u dëmshpërblye për to¹⁰. Nga një shqyrtim i bërë në disa botime të jetëshkrimeve të ndryshme të hoxhallarëve në disa libra, ku numri i këtyre jetëshkrimeve arrin në 530 kam nxjerrë disa të dhëna, por ajo që na intereson është sekuestrimi i bibliotekave të tyre. 23 hoxhallarëve iu sekuestruan bibliotekat e pasura, të cilat kishin libra në tre gjuhët klasike të Lindjes (arabisht, turqisht dhe persisht), por edhe dorëshkrime shqip me alfabet arab u dogjën e u dëmtuan dhe kanë shpëtuar shumë pak nga fondi i këtyre bibliotekave. Kështu librat e bibliotekës së Hafiz Sulejman Lilës nga Bastari i Tiranës do të digjeshin pas vdekjes së tij në vitin famëkeq 1967¹¹. Po të njëjtën gjë tregon edhe ish-myftiu i Beratit Qeramedin Durdia, i cili thotë se pjesën më të madhe të bibliotekës së babait të tij e shkatërruan dhe 4 apo 5 libra që i konsideronin shumë të vlefshëm i dërguan te disa të afërm shumë të besuar dhe në këtë mënyrë shpëtuan¹². Në vitin 1964 mbyllet përfundimisht Medreseja e Tiranës, kurse librat fetare mblidheshin dhe asgjësoheshin, duke u mbyllur mundësia

9 Shyqyri Hysi, *Muslimanizmi në Shqipëri në periudhën 1945-1950*, (Tiranë: Mësonjëtorja, 2006), 62-65.

10 Ali M. Basha, *Rrugëtimi i Fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)* (Tiranë: Botimi Privat, 2011), 459.

11 Xhemal Balla, *Personalitete të Kulturës Fetare e Atdhetare në Tiranë*, (Tiranë: KMSH, 2014), 65.

12 Dëshmi nga e kaluara, intervistë e dt. 12/11/2019 me ish-myftiun Qeramudin Mehmet Durdia- Berat.

e nxjerrjes së njerëzve të arsimuar fetarisht¹³. Hafiz Neshit Saliut i cili arratiset nga Kosova e vendoset në Shqipëri dhe shërben në Shkodër, Durrës dhe në fund në Kërçukje të Tiranës, forcat e Sigurimit famëkeq e arrestojnë dhe e mbajnë për 23 ditë në vitet 1960, duke i bërë presion nën akuzën “për agjitacion e propagandë dhe agjent i revizionizmit jugosllav”. Gjatë arrestimit ia grisnin të gjitha librat e fesë që kishte, por nuk pranon asgjë nga akuzat dhe për këtë shpëton¹⁴. Pas vdekjes së Hafiz Musa Qazim Kurushit dy sëndukët me librat e bibliotekës së tij u shitën apo u dogjën nga frika nga njëri prej djemve të tij pas vitit 1967¹⁵. Një rast i pazakontë është ai i hoxhë Sulejman Kodra nga Vilëza e Tiranës, të cilit i shkuan në shtëpi, kur ai nuk ishte dhe ia morën librat fetare e Kuranin për t’ia djegur. Menjëherë e lajmëruan, e me shumë guxim ai i akuzoi si hajdutë, sepse kishin hyrë e dhunuar shtëpinë pa prezencën e tij. U detyruan t’ia dërgonin librat dhe Kuranin, të cilët i mbajti me vetëmohim deri në fund të jetës.¹⁶ Emin Efendi Hoxholli (1880-1970) vaiz dhe myderriz në Xhaminë e Ballijes, Elbasan, internohet nga regjimi komunist nga viti 1953-1959, së bashku me familjen e tij. Ia marrin librat e bibliotekës dhe ia djegin¹⁷. Për të pasur një ide rreth numrit të librave që mund të ketë pasur një nga këto bibliotekat private të hoxhallarëve kemi rastin e hafiz Halim Rustem Hajdarit (1891-1965), i cili kishte në bibliotekën vet personale rreth 2,000 libra fetarë¹⁸. Kështu Haki Çoçka (1912-) hoxhë i katundit Potgorije, rrethi i Korçës në krahinën e Devollit, përveç akuzave për agjitacion e propagandë kundër pushtetit dhe sistemit kooperativist akuzohet se: “Ai në kundërshtim me udhëzimet e dhëna nga superiorët e tij ka mbajtur revista me përmbajtje armiqësore dhe i ka përhapur këto në persona të tjerë.”¹⁹

Studiuesi Dilaver Sadikaj thotë se krahas mbylljes së faltoreve (1967) u morën një sërë masash të tjera, si ato për zhdukjen e bazës materiale, duke përfshirë këtu edhe letërsinë fetare. Madje të rinjtë u hodhën në aksione për grumbullimin e të gjitha materialeve fetare, që ndodheshin në shtëpitë e fshatarëve dhe si rezultat i këtyre veprimtarive brenda një kohe të shkurtër prej disa muajsh iu dha tronditja e parë të gjithë vatrave të fesë dhe traditës historike kulturore e arsimore fetare në Shqipëri²⁰.

13 Ali M. Basha, *Rrugëtimi i Fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)* (Tiranë: Botimi Privat, 2011), 515.

14 *Drita Islame*, nr. 10 (1992): 3.

15 Dëshmi nga e kaluara, intervistë me Behaudin Kurushi, 27 tetor 2018.

16 Xhemal Balla, *Personalitete të Kulturës Fetare e Atdhetare në Tiranë*, (Tiranë: KMSH, 2014), 141.

17 *Drita Islame*, nr. 8 (1998): 3.

18 Smajl Bala, *Institucionet Islame dhe hoxhallarët e Shkodrës* (Shkodër: Camaj –Pipa, 2005), 258.

19 Haki Çoçka, AMPB, D. 2733, 1-3.

20 Dilaver Sadikaj, “Pozita e fesë në Shqipëri në kushtet e sistemit komunist,” *Feja, Kultura dhe Tradi-*

Botimet ateiste si mbushje e boshllëkut të literaturës fetare

Botimet me frymë të theksuar ateiste, anti-klerikale dhe antifetare kanë qenë një nga mjetet themelore të përdorura për të luftuar fenë, për shkatërrimin e ndikimit të saj në shoqëri si dhe për të zëvendësuar literaturën e regjimeve të shkuara. Qysh në momentet e para të pas-marrjes së pushtetit nga Partia Komuniste fillojnë botimet mbi shkencën, ateizmin shkencor dhe kundër fesë, me libra me tituj propagandistikë, të cilët në thelb e dënonin fenë si reaksionare, obskuran-tizëm, frenuese të proceseve revolucionarizuese, anakronike, antishkencë, për shtypjen dhe diskriminimin e rolit të gruas në shoqëri etj. Në vijim do të gjeni një listë të disa prej këtyre botimeve, si dhe tirazhin e botimit të tyre, i cili në vitin 1967 kap shifra të larta. P.sh., “Lufta kundër zakoneve prapanike dhe besimeve fetare shprehje e luftës së klasave, Tiranë 1967, 15,000 kopje,” ndërsa “Thelbi reaksionar i muslimanizmit, Mina Qirici, Tiranë 1967, 4,000 kopje,” apo edhe “Nuk ka liri të vërtetë shoqërore pa emancipimin e plotë të gruas, Tiranë 1967, 15,000 kopje. Shihet qartë nga shifrat se regjimi komunist ka nisur një luftë të rregullt për çrrënjosjen përfundimtare të fesë dhe zakoneve e traditave të saj të përhapura në popull. Në krahasim me popullsinë e atij dhjetëvjeçari këto tirazhe janë me të vërtetë të larta, duke parë edhe format e edukimit masiv që përdorte regjimi. Në regjistrimin e vitit 1960 kemi një popullsi prej 1,607,300, kurse në vitin 1970 kemi një popullsi pre 2,135,600 frymësh²¹, ku 29,5% e popullsisë banon në qytet dhe 70,5% në fshat²². Procesi mësimor në Medresenë e Tiranës u dëmtua shumë nga propaganda ateiste dhe antifetare, e cila filloi të zhvillohej haptas. Nxënësit e Medresesë josheshin me punë me rroga të mira në sektorin shtetëror, dhe që nuk mund të injoroheshin për shkak të vështirësive ekonomike që po kalonte vendi²³. E gjithë kjo literaturë ateiste u përdor me format e veta propagandistike për ta larguar popullin nga ndërtesat e kulteve fetare dhe për ta ndaluar ushtrimin publikisht të besimit dhe të rriteve të ndryshme fetare.

1. Krijimi i jetës mbi tokë, A. I. Oparin, Tiranë 1946.
2. Mbi rendin në Gjithësi, V.V. Shoronov, Tiranë, 1946.
3. A ka ekzistuar Krishti, K. L. Voropajeva, Tiranë 1958, 2,000 kopje.
4. Feja është opium për popullin, Tiranë 1964, 4,000 kopje.

ta Islame ndër Shqiptarët (Prishtinë: BIK, 1995), 504.

21 Vjetari statistikor i Shqipërisë, Ministria e Ekonomisë, Drejtoria e Statistikës, 1991, 35.

22 Po aty, 35.

23 Shyqyri Hysi, *Muslimanizmi në Shqipëri në periudhën 1945-1950*, (Tiranë: Mësonjëtorja, 2006), 151.

5. Thelbi reaksionar i muslimanizmit, Mina Qirici, Tiranë 1967, 4,000 kopje.
6. “Çudirat” e fesë, Mina Qirici, Tiranë 1967, 3,000 kopje, 35 faqe.
7. Mbi festat dhe të kremtet fetare (kundër Krishterimit), Tiranë 1967, 10,000 kopje, 44 faqe.
8. Darwinizmi dhe feja, G. V. Platonov, Tiranë 1967, 4,000 kopje.
9. Nuk ka liri të vërtetë shoqërore pa emancipimin e plotë të gruas, Tiranë 1967, 15,000 kopje.
10. Lufta kundër zakoneve prapanike dhe besimeve fetare shprehje e luftës së klasave, Tiranë 1967, 15,000 kopje.
11. Akuzojmë fenë, Hulusi Hako, Tiranë 1968, 5,000 kopje, 144 faqe.
12. Manifesti i Partisë Komuniste, K. Marks e F. Engels, Tiranë 1968, 10,000 kopje.
13. Ideologjia reaksionare e klerit në vitet 30 të shekullit XX, Viron Koka, Tiranë 1969, 5,000 kopje.
14. Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë II, Tiranë 1969, 10,000 kopje.
15. Biseda mbi fenë dhe dijen, Tiranë 1970, 5,000 kopje, 210 faqe.
16. Në luftë për një shkollë e pedagogji socialiste, Hamit Beqja, Tiranë 1986, 6,000 kopje.

Disa të dhëna interesante na jepen nga gazeta *Zëri i Popullit* organi zyrtar i Partisë së Punës së Shqipërisë, ku sipas një raportimi të bërë në faqet e saj: “Në vjetët 1945-1953 janë botuar më shumë se 1500 lloje librash politike, letrare etj., në më shumë se 12,000,000 kopje, pa llogaritur me miliona libra arsimorë”. Po në këtë periudhë kohore botimet e klasikëve të marksizëm-leninizmit janë më shumë se 90 libra në afro 1,200,000 kopje. Ndërsa numri i librave politikë me më shumë se 190 lloje të botuara arrin në më shumë se 2,100,000 kopje. Gjatë periudhës 1948-1953 janë botuar 60 vepra të autorëve shqiptarë të realizmit socialist, si Dhimitër Shuteriqi, Sterjo Spase, Fatmir Gjata, Zihni Sako etj., me më shumë se 500,000 kopje²⁴.

Sado të fryra të duken këto shifra për një vend që nuk i kishte akoma 1 milionë banorë, përfshijnë një realitet të prekshëm dhe një dëshirë të madhe për ta përmbytur me literaturën e re socialiste të gjithë prodhimin letraro-shpirtëror

24 V. Koroshi, “Botimi i librave në vendin tonë,” gazeta *Zëri i Popullit* (1954): 3.

të mëparshëm, ku i gjithë ky prodhim u konsiderua nga censura e pushtetit si literaturë e ndaluar dhe që u reflektua me shkatërrimin kryesisht të të gjithë literaturës fetare më pas më 1967. Po në faqet e kësaj gazete njoftohemi, se që nga çlirimi i vendit dhe deri më sot (prill 1960) janë botuar 68 libra me artikuj dhe fjalime të V. I. Leninit me një tirazh të përgjithshëm prej 500,000 kopjesh²⁵. Në një relacion të Komitetit për Çështje Klerike drejtuar Kryeministrisë ku flitet për propagandën antifetare kanë dalë libra (broshura) shkenca dhe feja, mbi katoliçizmin, janë vënë në revistën Hosteni dhe gazetën Bashkimi disa klerikë me raste bëriesh nuskash ose për kënduarie të sëmurish. Në grumbuj punëtorësh (kampe etjera) janë spjeguarë mbi fenomenet e natyrës (dielli, hëna, toka, shiu etj)²⁶.

Propagandë e ashpër antiklerikale dhe antifetare në faqet e gazetave zyrtare të kohës

Krahas botimeve të ndryshme ateiste qysh në ditët e para dhe në vitet në vazhdim i është kushtuar një vëmendje e veçantë “demaskimit” të zakoneve prapanike, emancipimit të gruas, lufta kundër fesë dhe zakoneve të saj, besimet e kota, çlirimi nga këto tradita të prapambetura fetare dhe ku kanë pasur mundësinë edhe ta marrin objektin e xhamisë si ndërtesë për ta përdorur për nevojat e kooperativës, si pjesërisht por edhe të tërën. Këtu kanë hasur në kundërshtimet e forta jo vetëm të strukturave të KMSH-së, por edhe të besimtarëve. “65 xhami gjenden në qytetin dhe fshatrat e Shkodrës së bashku me 74 kisha dhe që rëndojnë “mbi shpatullat e popullit”²⁷- kështu i shihte propaganda zyrtare e regjimit institucionet e kultit. Ndërkaq vetë populli nuk ishte ankuar ndonjëherë për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tyre dhe tradita tregon të kundërtën, ku vetë fshatrat apo qytetet i ndërtonin vetë xhamitë dhe kishat dhe prej shumë brezash kujdeseshin për to.

Në luftën ndaj besimeve të kota dhe fanatizmit në gazetën Zëri i Popullit ju kërkohet komunistëve të rrethit të Skraparit, ku ka shumë teqe e tyrbe të ushtrojnë influencën e tyre mbi masat. Madje më e qartë është kur thuhet, se: “Disa komunistë mendojnë se meqë kushtetuta e garanton ata kanë të drejtë të besojnë ose të mos luftojnë kundër influencës së saj në masat, të mos punojnë për t’i çliruar punonjësit nga influenca e saj (e fesë- shën. aut.) e për t’i pajisur me një botkuptim shkencor.” Autori i shkrimit dënon komunistët e fshatit Leskovë pse i kanë

25 Sokrat Dedja, “Përhapja dhe influenca e ideve të Leninit në Shqipëri,” *Zëri i Popullit* (1960): 3.

26 Fondi i Këshillit të Ministrave- Fetare, F. 490, V. 1955, D. 1303, F. 5.

27 Rifat Dajti, “Fakte që akuzojnë,” *Zëri i Popullit* (1968): 3.

dhënë hoxhës së fshatit bereqet, e për këtë ua bën të qartë komunistëve, se: “... duhet të jetë e qartë se ndërsa ligjet garantojnë lirinë e fesë, ideologjia e partisë nuk pajtohet me ideologjinë fetare.²⁸” Fryma e shkrimit në vijim është për një aktivizim më të madh të komunistëve, të cilët duhet të merren më tepër me gratë dhe t’u japin të drejta të barabarta me burrat, dhe kështu do të luftohen me efikasitet si zakonet prapanike ashtu dhe fanatizmi i burrit në fshat.

Ndërsa në fshatin Aliaj, Koplík- Malësi e Madhe i kanë detyruar fshatarët nga tre ditë që bënin pushim për Bajram të bëjnë vetëm një. Po ashtu në kuadrin e luftimit të besimeve të kota dhe fesë fshatarëve iu është shpjeguar me eksperimente praktike, se si formohet shiu, breshri e bora nga procesi i avullimit dhe i kondensimit në atmosferë për të larguar “besimet e kota” nga mendjet e fshatarëve, që besojnë se i fal Zoti²⁹.

Një nga format e përhapura asokohe nga strukturat e ndryshme shtetërore dhe partiake ka qenë edhe “Ora e Informacionit Politik”, ku lexoheshin gazetat e ndryshme dhe instruktorët e Komiteteve të PPSH në qendra e në fshatra nëpërmjet leximit të gazetave zhvillonin propagandën partiake. Pra i detyronin fshatarët dhe punëtorët nëpër qendrat e tyre të punës të dëgjonin rregullisht atë që PPSH kishte përgatitur nëpërmjet mjeteve të ndryshme të propagandës, madje edhe të diskutonin nën frymën e kësaj propagande. Sipas kryetarit të Frontit Demokratik pasi 100% e fshatit Boçevë të Peshkopisë ka hyrë në kooperativë për çdo mbrëmje pasi kthehen nga puna shkojnë në shtëpinë popullore të leximit, ku lexojnë gazetat Bashkimi, Zëri i Popullit dhe Bujqësia Socialiste. Një punë e mirë sipas këtij raportuesi është bërë për ndërprerjen e besëtytnive dhe zakoneve prapanike, si fjala vjen në të kaluarën hoxha i fshatit shkante për natë gjatë Ramazanit për vizita, ku shtroheshin darka (iftare) dhe thereshin bagëti dhe tashti nuk ndodhin më. Grave të fshatit tashmë ua kanë hequr “perçen e dikurshme” dhe tashti marrin pjesë në mbledhjet e Frontit Demokratik³⁰.

Një nga mënyrat për ta luftuar fenë ka qenë edhe lufta kundër “nuskave e hajmalive”, dhe ndaj atyre “shëruesve” që përdornin petkun fetar për t’u paraqitur si “shërues”, pra demaskimi i shkruessve të nuskave e hajmalive si përfaqësues të fesë. Në një fejtun të ZP përshkruhet një i ashtuquajtur “hoxhë” i fshatit Mollagjesh në lokalitetin e Funarit të rrethit të Elbasanit, i cili pasi ka parë një

28 Q. Sadko, “Besimet e kota e fanatizmi çduken me një punë sqaruessë të vazhduesshme,” *Zëri i Popullit*, (1957): 2.

29 P. Kranja, “Si punon shtëpia popullore e leximit për çdukjen e zakoneve prapanike?,” *Bashkimi*, (1958): 3.

30 K. Kurti, “Puna jonë për luftimin e zakoneve prapanike,” *Bashkimi*, (1958): 2.

ëndërr hiqet si shërues dhe ju bën “duva” njerëzve që t’i shërojë. Ky i ashtuqajtur “hoxhë” paraqitet duke mbajtur Kuranin në dorë dhe me një palë tespije fildishi dhe ju këndonte “duva” njerëzve dhe e mallkonte shejtanin për ta larguar. “Hoxha i Mollagjeshit” kishte marrë shumë famë, saqë edhe hoxhallarë të tjerë u bënë kuriozë se si i shëron ky njerëzit. “Bile hoxhë Y.H., nga Labinoti s’u kursye të shkojë deri në Mollagjesh për të marrë vesh ç’ngjiste.”³¹ Atij iu desh të priste dy ditë për ta takuar “hoxhën e Mollagjeshit”, i cili nuk ia tregoi “sekretet e shërimit”. “Por hoxhë Ramazani, ky njeri i shejtë që nën petkun e fesë mashtroi mjaft njerëz, e mbylli shpejt aktivitetin e tij, sigurisht jo me dëshirën e vet: të palarat i dolën në shesh në gjyqin që organizuan, organet e drejtësisë në fshatin Mollagjesh...” Autori i shkrimit shpreh një shqetësim tjetër, se megjithëse ky hoxhë e mbylli punën e vet, por ka akoma njerëz me mendime prapanike, të cilët tërhiqen për hundësh “nga dallaveraxhinj të tillë si hoxhë Ramazani e ndonjë shok i tij.”³² Po ashtu kemi edhe disa raste të tjera në Gramsh e fshatrat e Tiranës.

Në një shkrim tjetër në faqet e ZP flitet mbi nuskat dhe hajmalitë e bëra nga nga disa hoxhallarë të Gramshit dhe më specifikisht rastin e një gruaje të sëmure me peritonit tuberkular, e cila u shërua në spitalin e Gramshit nga mjeku M.K. Sipas shkrimit ky mjek kishte hasur në disa raste, kur fshatarët kishin shkuar t’ju shkruheshin nuska e hajmali. Mjeku M.K. ua ka marrë këto nuska dhe në rastin e kësaj gruaje të sëmure me peritonit tuberkular hajmalitë kishin brenda “copra gazete, letra, pendë, luspa gështenje, bar të thatë, pleh, kocka...” Pas mjekimit me barna në spital gruaja u shërua, ndërsa mjeku filloi t’i mblidhte nga fshatarët këto hajmali dhe kishte bërë një ekspozitë për t’i demaskuar këto besëtytni, duke i vendosur ato në një vend të dukshëm të një ndërtese në qytetin e Gramshit. Vizitorët e kësaj ekspozite vendoseshin përpara pyetjes (sipas shkruarit të artikullit): “A mund të shërohem me gjepura të tilla që quhen nuska? JO!”³³

Fshatarësia e rrethit të Tiranës në të kaluarën ka qenë mjaft e prapambetur dhe fshatari i rrethit të Tiranës e njihte shumë pak mjekun dhe mendonte, se mund të shërohej vetëm me nuska e hajmali, e me duvatë e hoxhallarëve,- theksohet në një nga shkrimet e shumta kundër paragjykimeve fetare. Drejtori i shkollës “Kajo Karafili” në fshatin Vaqarr të Tiranës pasi ia mori një nuskë një djali nxënës i kësaj shkolle vërejtë se ishte “e shkruar në turqisht”³⁴. Ai shkoi në Tiranë dhe e përktheu dhe të nesërmen ua lexoi nxënësve se çfarë shkruhej në atë nuskë dhe kur

31 Ruzhdi Hoxha, “Poliklinika e hoxhë Ramazanit”, *Zëri i Popullit*, (1959): 2.

32 Po aty.

33 Dritëro Agolli, “Fati i nuskave”, *Zëri i Popullit*, (1960): 3.

34 Kastriot Zoraqi, “Kundër paragjykimeve,” *Zëri i Popullit*, (1960): 3.

ata dëgjuan që shkruhej: “O zot jepi shëndet.”- të gjithë filluan të qeshin. Në këtë shkrim jepen edhe disa raste të tjera, që kanë të bëjnë me besimet popullore. Shkruesi na tregon, se “Ka akoma tek ne njerëz që shtien fall, që besojnë se me anën e nuskave mund të shërohen nga sëmundjet, se me anën e disa ceremonive fetare mund të sigurojnë mirëqenien dhe lumturinë.” Për të luftuar këto zakone të dëmshme në këtë vit (1960) planifikonin të realizonin një ekspozitë ambulante me nuska e hajmali të tilla, si dhe ngritjen e 10 vatrave të reja të kulturës, që do të shërbejnë si qendra edukimi për fshatarët “kundër besimeve të kota dhe zakoneve prapanike”³⁵. Ndërkaq nga ana doktrimore pavarësisht se besimet dhe besëtytnitë e mësipërme realisht kanë qenë të përhapura në popull dhe fryma e tyre mbahej gjallë nga njerëz të papërgjegjshëm myftinj të zyrat e ndryshme në varësi të KMSH-së kanë bërë përpjekjet maksimale për t’i denoncuar dhe për t’i larguar njerëzit apo popullin nga këto veprime. Një nga këto veprime është ai i myftiut të Beratit Rrapo Rustemi, i cili ka denoncuar publikisht një “grua profeteshë”, e cila e mashtronte popullin për interesa materiale. Myftiu Rrapo Rustemi ka njoftuar KMSH-në dhe vetë kryetari i KMSH-së H. Musa Aliu ia ka adresuar si çështje organeve të drejtësisë së kohës, në Prokurorinë e Beratit dhe Ministrinë e Drejtësisë, siç jepet në njoftimin zyrtar³⁶. Edhe më herët në faqet e revistës zyrtare të KMSH-së ka pasur njoftime të tilla, mirëpo me daljen e numrit të fundit të saj të janar-shkurtit 1946 mbyllet dera e vetme e komunikimit të KMSH me publikun shqiptar. Gjithsesi strukturat e KMSH-së e kanë vazhduar punën e tyre për denoncimin e rasteve të tilla dhe kjo shihet në korrespondencën e KMSH me Myftiun e Elbasanit mbi ndalimin e hoxhallarëve e shehlerëve të shkruajnë nuska e të hedhin fall³⁷. Po ashtu kemi një korrespondencë të Nënmyftiut të Krujës drejtuar imamit të Xhamisë së Krujës mbi ndalimin e nuskave³⁸. Po ashtu vazhdon kjo lloj korrespondence edhe në vitin 1951 ndërmjet Kryesisë së KMSH me Kryemyftininë e Tiranës dhe Myftininë e Durrësit për bërje nuskash e besimesh të kota³⁹. Po ashtu kemi edhe një “Vendim i Komunitetit Mysliman dhe qarkore e Kryesisë së Komunitetit mbi luftimin e disa zakoneve prapanike dhe besimeve të kota si nuska, falleve, shitja e vajzave.”⁴⁰ Kryetari i KMSH-së Sulejman Myrtoj i është drejtuar katër Kryemyftinive të Tiranës, Korçës, Shkodrës e Vlorës në qarkoren e sipërpërmendur, ku i porosiste, që gjatë predikimeve

35 Po aty.

36 Rrapo Rustemi, “Një grue profetizuese e rrejshme,” *Kultura Islame*, nr. 5-8 (1945): 100-101.

37 AQSH- Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, F. 482, V. 1946, D. 83, janar- shtator 1946.

38 AQSH- Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, F. 482, V. 1947, D. 68.

39 AQSH- Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, F. 482, V. 1951, D. 79.

40 AQSH- Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, F. 482, V. 1960, D. 72, F. 1.

në faltoret t'i jepej përparësi kolektivizimit, kooperativizimit dhe reformave që janë në të mirë të popullit. Po ashtu martesës së vajzave që shiten me të holla, të flasin kundër shkrimit të nuskave, gjithashtu imamët duhet të kenë kujdes të luftojnë besëtytnitë, hedhjen e fallit, besimet e kota dhe paragjykime të tjera. Imamët përpara se të bëjnë aktin e martesës duhet të jenë të sigurtë që është bërë kurorëzimi në gjendjen civile të pushtetit lokal. Në vijimësi kohore KMSH e ka vazhduar përpjekjen e vet kundër këtyre lloj fenomeneve, që për synim kanë pjesën materiale të përfitimit të kjo lloj kategorie njerëzish, por që u shfrytëzua nga propaganda e regjimit komunist me shumë zgjuarësi për të njollësuar fenë dhe petkun fetar të hoxhallarëve, ndërkohë që KMSH-së i mungonte krejtësisht mundësia e komunikimit me publikun qoftë nëpërmjet një organi të vet media-tik, por që nuk iu la asnjë hapësirë tjetër edhe nga ana e propagandës shtetërore.

Përpjekje tjetër e propagandës zyrtare ka qenë edhe debati doktrinor, ku shkruet të ndryshëm janë marrë me trajtimin e temave të ndryshme fetare, duke i trajtuar si të dëmshme fjala vjen për agjërimin. Gazeta Zëri i Rinisë i kushton një vëmendje të posaçme luftimit të paragjykimeve dhe zakoneve fetare me një dyfaqesh të plotë me tituj të ndryshëm. Në këtë numër spikasin dy shkrime me titull: “Ramazani dhe kreshmët” dhe “I ka zënë agjërimi”. Si kundërvënie jepen disa shkrime shkencore si: “A i ka krijuar Zoti ligjet e natyrës”, “Si doli njeriu mbi dhe” dhe jeta e Xhordano Brunos. Në shkrimin “Ramazani dhe kreshmët” tregohet mbi besimet e të krishterëve dhe muslimanëve që kanë për botën pas vdekjes, dhe se një gjë e tillë nuk ekziston, pra bota e përtejme. Sipas autorit të këtij shkrimi “Myslimanët, sipas Kuranit duhet të durojnë çdo fatkeqësi, dhunë, të gjitha mendimet e tyre duhet të jenë drejtuar nga “jeta” që nuk egziston...⁴¹” Predikimet e fesë për të hequr dorë nga gëzimet e kësaj jete përbëjnë një nga ti-paret më antinjerëzore, më reaksionare të moralit fetar,- shprehet shkruesi. “Ka pasur raste kur besimtari ramazanlli i sëmurë ka vënë në rrezik jetën e tij, sepse nuk ka pranuar të mjekohej e të merrte rregullish barërat për të mos “prishur” ramazanin.⁴²”

Ndërsa në shkrimin tjetër “I ka zënë agjërimi” një mjek jep këshillat e tij pse agjërimi, kreshmët (një lloj agjërimi apo pehrizi i të krishterëve- shën.aut.) apo matem (pehrizi i bektashive- shën.aut.) janë të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe për të qenë të shëndetshëm dhe për ta ruajtur atë “krahas masave të tjera të flakim disa paragjykime, besime dhe bindje”. Sipas këtij mjeku agjëruesis: “Ata

41 “S. Ramazani dhe kreshmët,” *Zëri i Rinisë*, (1959): 3.

42 Po aty.

bëhen si të hutuar, nevrrik dhe të bezdisur.⁴³ Shkak për këtë sipas tij bëhet ndryshimi i orareve të të ngrënit dhe gjumit e për pasojë “këta persona nuk janë në gjendje që të arsyetojnë, të sillen, të veprojnë apo të qëndrojnë në shoqëri në një mënyrë të drejtë dhe të mirë⁴⁴”. Këto besime, paragjykime dhe zakone nuk sjellin asgjë të mirë dhe rrezikojnë shëndetin, ku për fat të keq,- sipas autorit të shkrimit,- ka akoma njerëz me bindje të atilla, që ruajtja e matemit, kreshmës dhe ramazanit janë gjëra që ruajnë shëndetin, shpirtin dhe sigurojnë “xhenetin”. Këto besime e zakone bëhen pengesë për të qenë të shëndetshëm fizikisht dhe për të punuar me entuziazëm për ndërtimin e atdheut dhe të socializmit⁴⁵.

Përfundim

Në përfundim të këtij shkrimi mund të themi se tre mënyrat e përmendura këtu për shkatërrimin e mendimit islam dhe shpërlarjen e trurit të popullsisë ishin ndalimi i botimeve islame dhe shkatërrimi sistematik i asaj që u trashëgua më herët nga popullata, si revista Zani i Naltë, Kultura Islame dhe botime të tjera të vyera për përdorim të përditshëm, të cilat u mblodhën dhe u dogjën. Zëvendësimi i këtyre botimeve me literaturë propagandistike ateisto-shkencore e mbar-sur me ideologjinë marksiste leniniste dhe një propagandë e ashpër anti-fetare e orientuar nën etiketimet e ndryshme marksiste “lufta kundër zakoneve të vjetra e prapanike”, “emancipimi i gruas”, “feja opium për popullin” etj. Këto besime e zakone që i përkasin mendimit islam të formuara prej disa shekujsh u sulmuan dhe u stigmatizuan në të përditshmet komuniste Zëri i Popullit, Zëri i Rinisë, Bashkimi etj., të cilat shpërndaheshin në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe nxiteshin nga të gjithë komunistët për t’u lexuar masivisht në popullatë. Inxhinieringu social u ngrit në një nivel më të lartë pas vitit 1967, kohë kur u ndalua përfundimisht ushtrimi i edhe asaj pak feje në publik dhe kështu iu dha mundësia e artë të gjithë Komiteteve të Partisë së Punës në Shqipëri ta zhveshnin popullin shqiptar nga feja dhe traditat e saj përfundimisht. Kjo periudhë zgjati për 28 vite dhe breza të rinjsh u rritën pa fe dhe pa ditur asgjë për fenë.

43 Mjek Q. Cerga, “I ka zënë agjërimi,” *Zëri i Rinisë*, (1959): 3-4.

44 Po aty.

45 Po aty.

LITERATURA

- Revista Kultura Islame, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë 1939-1945
- Basha, Ali M. 2011. *Rrugëtimi i Fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)*, Tiranë.
- Hoxha, Enver. 1967. *Praktikat fetare t'i luftojmë me frymën patriotike dhe revolucionare të masave*, Vepra 35; IML.
- Shahu, Ajet. 1995. *Marrëdhëniet e shtetit komunist me fenë islame në Shqipëri (1945-1967).- Feja, Kultura dhe Tradita Islame ndër Shqiptarët*, BIK: Prishtinë.
- Sadikaj, Dilaver. 1995. *Pozita e fesë në Shqipëri në kushtet e sistemit komunist.- Feja, Kultura dhe Tradita Islame ndër Shqiptarët*, BIK, Prishtinë 1995.
- Hysi, Shyqyri. 2006. *Muslimanizmi në Shqipëri në periudhën 1945-1950*, Mësonjëtorja: Tiranë, 62-65.
- Balla, Xhemal. 2014. *Personalitete të Kulturës Fetare e Atdhetare në Tiranë*, KMSH: Tiranë, 65.
- Dëshmi nga e kaluara, intervistë e dt. 12/11/2019 me ish-myftiun Qeramudin Mehmet Durdia- Berat.
- Bala, Smajl. 2005. *Institucionet Islame dhe hoxhallarët e Shkodrës*, Camaj –Pipa: Shkodër.
- Gazeta Drita Islame, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.
- Gazeta Zëri i Popullit, orgna i Partisë së Punës të Shqipërisë.
- Gazeta Zëri i Rinisë, organ i Bashkimit të Rinisë të Punës të Shqipërisë.
- Gazeta Bashkimi, organ i Frontit Demokratik të Shqipërisë.
- Vjetari statistikor i Shqipërisë. 1991. Ministria e Ekonomisë, Drejtoria e Statistikës.
- Arkivi Qendror i Shtetit- Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Fondi 482.
- Arkivi Qendror i Shtetit -Fondi i Këshillit të Ministrave- Fetare, Fondi 490.